

eppc kërkon **Junior Project Manager** për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha ndërkombëtare në fushën e përkthimeve.

## Përgjegjësitë Kryesore:

1. Përshtat dhe përfshin përkthyesit dhe korrektorët në projekte, sipas aftësive teknike dhe *background-it* të tyre;
2. Monitoron ecurinë e përkthimeve të projekteve hap pas hapi duke respektuar përfundimin e tyre sipas afateve të përcaktuara;
3. Koordinon punën mes përkthyesve dhe korrektorëve, si edhe kujdeset që ekspertiza e përkthyesit të përputhet plotësisht me kërkesat e klientit;
4. Vlerëson cilësinë e punës së përkthyesve nëpërmjet *feedback-ut* të marrë nga korrektorët;
5. Kujdeset që çdo projekt të përfundojë me cilësi dhe brenda afateve të përcaktuara nga klienti.

## Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në **Gjuhë të Huaja, Shkencat Sociale, Marketing, MBA**; (*E preferueshme që kandidatët të kenë studiuar jashtë*)
- Përvojë e mëparshme **jo më pak se 2 vjetare në koordinim projektesh**;
- Të **zotërojë shkëlqyeshëm Gjuhën Angleze** në të shkruar dhe të folur; (*Domosdoshmëri*)
- Të **zotërojë shkëlqyeshëm paketën MS Office**; (*Domosdoshmëri*)
- Të njohë Sistemin Operativ Mac OS X dhe iOS;
- Aftësi shumë të mira komunikimi, organizimi, bashkëpunimi;
- Të punojë nën presion dhe të jetë i orientuar drejt detajeve.

## Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Junior Project Manager;
<b>Vendndodhja:</b>	Tiranë;
<b>Orari:</b>	40 orë në javë;
<b>Pagesa:</b>	Shumë e mirë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Kodit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	21.01.2016.

## Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[recruitments@eppc.al](mailto:recruitments@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.